



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

**Gjoritja e një grupi kompanish grumbulluese të produkteve bujqësore: një hap i rëndësishëm në mbrojtje të fermerëve dhe konkurrencës së ndershme.**

Autoriteti i Konkurrencës përfundoi vlerësimin e praktikave në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarqet Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë, pas një procedure të thelluar hetimore që zgjati gati dy vite dhe përfshiu monitorimin e tregut, hetimin paraprak dhe hetimin e thelluar.

Në mbledhjen e datës 26.11.2025, Komisioni i Konkurrencës miratoi vendimet nr. 1234–1239, me të cilat konstatoi se një grup ndërmarrjesh grumbulluese – Omer Fruit SHPK, Nedrete Arapi PF, Besim Thaqi PF, Morina Grup SHPK, Fruit-To-Zela SHPK dhe Roland-2012 SHPK – **kanë bashkërenduar çmimet e blerjes gjatë periudhave të sezonit**, duke diktuar çmimet në dëm të fermerëve dhe duke aplikuar **mark-up (shtesë mbi kosto) shumë të lartë**, deri në 115%.

Kjo sjellje e bashkërenduar përbën **marrëveshje të ndaluar** sipas nenit 4 të ligjit nr.9121/2003 dhe është cilësuar si **shkelje e rëndë**, për të cilën Komisioni ka vendosur gjoba deri në 0.15% të xhiros së vitit financiar paraardhës.

**Pse ky vendim është i rëndësishëm për fermerët në gjithë Shqipërinë**

Hetimi i thelluar tregoi se disa grumbullues, falë fuqisë së tyre negociuese, kishin krijuar një situatë ku fermerët shpesh përballeshin me:

- **çmime të diktuarra e të koordinuara,**
- **dyer të mbyllura për negociim,**
- **varësi të tepruar nga pak blerës,**
- **presione për uljen e çmimeve,**
- **dhe shlyerje të vonuara të pagesave.**

Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë këto problematika dhe **forcon pozitat e fermerëve në treg**, duke krijuar kushte për:

- **çmime më të drejta e më transparente,**
- **konkurrencë të ndershme mes grumbulluesve,**
- **mundësi reale zgjedhjeje për fermerët,**
- **pagesa më të sigurta dhe marrëdhënie më të balancuara kontraktuale,**
- **frenimin e skemave të koordinuara që dëmtonin të gjithë tregun kombëtar.**

Për më tepër, megjithëse gjobiten 6 ndërmarrje, **efekti i vendimit shtrihet në të gjithë tregun kombëtar**, sepse:

- sjell qartësi mbi praktikat e ndaluara,
- vendos standarde të reja për transparencën e çmimeve,
- synon disiplinimin e tregut të fruta-perimeve,
- dhe nxit konkurrencën e ndershme për të gjithë aktorët.

Kjo është një ndërhyrje strukturore me impakt të drejtpërdrejtë në zinxhirin ushqimor dhe një sinjal i qartë se Autoriteti i Konkurrencës **mbron interesat e fermerëve**, një kategori që shpesh përballet me pabarazi të theksuar në negociata.

#### **Detyrime dhe masa korigjuese për grumbulluesit**

Komisioni ka urdhëruar ndërmarrjet e gjobitura që:

- të afishojnë në mënyrë të dukshme çmimet aktuale të produkteve që grumbullojnë,
- të jenë subjekt monitorimi për 1 vit nga Autoriteti i Konkurrencës.

Këto masa synojnë rritjen e transparencës dhe krijimin e një tregu më të drejtë për fermerët. **Rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Me vendimin nr. 1240, Komisioni i Konkurrencës ka adresuar institucionet përgjegjëse me rekomandime të rëndësishme për reformimin e tregut, përfshirë:

- **minimizimin e informalitetit në gjithë zinxhirin e tregtimit,**
- **hartimin e një baze të re ligjore në përputhje me standardet e BE,**
- **krijimin e një platforme kombëtare online të çmimeve (bursë agro-ushqimore),**
- **vendosjen e kontratave të detyrueshme dhe të standardizuara,**
- **dhe bashkëpunimin për transpozimin e Direktivës së BE për praktikat tregtare të padrejta (UTP).**

Nëpërmjet këtyre vendimeve, Autoriteti i Konkurrencës vijon përmbushjen e misionit të tij për të garantuar konkurrencë të lirë dhe të ndershme, duke kontribuar drejtpërdrejt në mbrojtjen e fermerëve, rritjen e transparencës dhe funksionimin më të drejtë të tregut agro-ushqimor në Shqipëri